

URDHËR
Nr. 278, datë 31.10.2019

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58 datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrisë Qendror, z. Agron Cani.

2. Z. Agron Cani i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, i ndryshuar;
- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;
- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;
- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit në funksion të Kontrollit të Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, përgjegjësit të sektorit për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, z. Adhurim Hasanaj.

4. Z. Adhurim Hasanaj i delegohen kompetencat, si më poshtë:

- a) mbikëqyr dhe udhëzon Grupin e Punës për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;
- b) përfaqëson Grupin e Punës në marrëdhëniet me:
 - Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK);
 - Kolegjin e Apelit (KA) dhe Komisionerët Publikë;
 - Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).
- c) organizon dhe drejton veprimtarinë e Grupit të Punës;
- ç) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur Grupi i Punës;
- d) merr dhe trajton korrespondencën shkresore që lidhet me veprimtarinë e Grupit të Punës.

5. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 4.11.2019, deri në datën 11.11.2019.

6. Z. Agron Cani dhe z. Adhurim Hasanaj nuk mund të nëndelegojnë këto kompetenca.

7. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrisë Qendror.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR

